



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I FILOLOGJISË
PRISHTINË

| | | | |
|------------------------|-------|---------|-------|
| Pranuar më: 20.06.2022 | | | |
| Nj. org. | Numer | Shtolca | Vlera |
| 03 | 3544 | 3 | 1 |

**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM**

Fakulteti

I Filologjisë

Lëndët

Sintaksë e gjuhës angleze1, Sintaksë e
gjuhës angleze 2, Morfologji e gjuhës
angleze 1, Morfologji e gjuhës angleze 2

Kandidatët e paraqitur

1. Zana Prekazi
2. Eglantina Bilalli
3. Ariana Kuçi
4. Libron Kelmendi

Komisioni vlerësues

1. Kryetar
2. Anëtar
3. Anëtar

Prof. Asoc. Dr. Lindita Tahiri
Prof. Ass. Dr. Blerta Mustafa
Prof. Ass. Dr. Lendita Kryeziu



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Fakulteti i Filologjisë

Për: Këshillin e Fakultetit të Filologjisë

CC: Prof.asoc. dr. Lindita Rugova, Dekane e Fakultetit

Lënda: Raport dhe propozime të komisionit për vlerësimin e kandidatëve të paraqitur në Konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ushtrime për vitin akademik 2022/23

Komisioni në përbërje: 1. Prof.asoc.dr. Lindita Tahiri (kryesuese), 2. Prof. Ass. Dr. Blerta Mustafa dhe 3. Prof. Ass. Dr. Lendita Kryeziu, me Vendimin nr. Prot: 01/3457, të datës 14.06.2022, pasi shqyrtoi dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur në konkursin me nr, prot: 1/217, të datës 01.06.2022, shpallur nga UP-ja në uebfaqen zyrtare, si dhe duke u mbështetur në dispozitat Statutit të UP-së,

Propozon

Që për vitin akademik 2022/23, të angazhohet: **bashkëpunëtorë e jashtëm** në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze:

Në vijim e gjeni RAPORTIN e detajuar lidhur me të dhënat e kandidatëve që kanë konkuruar për pozitën bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime për lëndët nr. 18 për lëndët Sintaksë e gjuhës angleze1, Sintaksë e gjuhës angleze 2, Morfologji e gjuhës angleze 1, Morfologji e gjuhës angleze 2 dhe vendimin e komisionit.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

Propozohet:

MA Zana Prekazi (lindur më: 28.11.1990) ka konkuruar për pozitën numër 18 të konkursit publik të datës 01.06.2022. Kandidatja ka përfunduar studimet Bachelor në UP, Fakulteti i Filologjisë-Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, me notën mesatare 8.78. Ka përfunduar gjithashtu studimet Master në të njëjtin Departament më notën mesatare 9.18. Kandidatja është në proces të finalizimit të temës së doktoratës në Universitet të Prishtinës nga fusha e morfo-sintaksës, fushë kjo për të cilën është shpallur kjo pozitë në konkurs. Ka përvojë pune katër vjeçare në Universitetin e Prishtinës, në departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, si asistente e angazhuar për Sintaksën 1 dhe 2. Që nga viti 2016 punon si përkthyes në Ministrinë e Drejtësisë dhe gjashtë vite si mësimdhënëse në SHFMU "Elena Gjika". Ka publikime në revista ndërkombëtare dhe një në revistën Filologji. Ka të përfunduara gjashtë seminare dhe trajnime në fushën e mësimdhënies. Ka treguar performancë të shkëlqyeshme në fushën përkatëse dhe gatishmëri për të ndihmuar në procesin e mësimdhënies dhe kryerjet e obligimeve e përgjegjësive që dalin si kërkesë e kësaj pozite. Po ashtu, ka ndihmuar në përkthimin e dokumenteve gjatë procesit të akreditimit të programeve të Fakultetit të Filologjisë si dhe Universitetit. Rrjedhimisht, komisioni e *propozon* për angazhim në pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për lëndët: Sintaksë e gjuhës angleze1, Sintaksë e gjuhës angleze 2, Morfologji e gjuhës angleze 1, Morfologji e gjuhës angleze 2.

Refuzohen:

MA Ariana Kuçi (lindur më: 08.02.1994) ka konkuruar për pozitën numër 18 të konkursit publik të datës 01.06.2022. Ka përfunduar studimet Bachelor në UP, Fakulteti i Filologjisë-Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, me notën mesatare 7.48. Ka përfunduar gjithashtu studimet Master në të njëjtin Departament më notën mesatare 7.36. Nuk ka dëshmi të trajnimeve dhe konferencave, përkundër asaj që në CV ka prezantuar disa prej tyre. Po ashtu nuk ka ndonjë dëshmi për përvojë në mësimdhënie në arsimin parauniversitar dhe atë të lartë. Kandidatja në fjalë *nuk propozohet* për bashkëpunëtorë të jashtëm, sepse ka notën mesatare në të dy nivelet e studimit më të vogël se 8, që bie ndesh me pikën 3.2. të nenit 7 të rregullores nr.1/95 me datë 24.06.2021.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

MA Libron Kelmendi (lindur më: 29.01.1996) ka konkuruar për pozitën numër 18 të konkursit publik të datës 01.06.2022. Ka përfunduar studimet Bachelor në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani", Fakulteti i Filologjisë-Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, me notën mesatare 9.48. Ka përfunduar gjithashtu studimet Master në Universitetin e Evropës Juglindore me notën mesatare 9.50. Në dokumentet e ofruara mungon noterizimi i nostrifikimit të diplomës. Ka publikime në revista ndërkombëtare. Nuk ka ofruar asnjë dokument të trajnimeve për mësimdhënie dhe konferencave. Ka një vjet përvojë pune në mësimdhënie në arsimin e lartë. Kandidati në fjalë **nuk propozohet** për bashkëpunëtor të jashtëm, sepse ka përvojë më të shkurtër në fushën përkatëse sesa kandidatja e propozuar, kriter ky i përcaktuar sipas pikës 3.5. të nenit 7 të rregullores nr. 1/95 me datë 24.06.2021.

Dr Sc Eglantina Bilalli (lindur më: 04.04.1991) ka konkuruar për pozitën numër 18 të konkursit publik të datës 01.06.2022. Ka përfunduar studimet Bachelor, MA dhe ato të Doktoratës Universitetin e Evropës Juglindore. Në dokumentet e paraqitura mungon noterizimi i nostrifikimit të diplomave të të gjitha niveleve. Ka përvojë 10 vjeçare në fushën e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe universitar. Sipas dokumenteve të ofruara kandidatja është e punësuar me kontratë të plotë në UBT dhe ka angazhim të pjesshëm në shkollën e mesme të artit pamor "Adem Kastrati", që bie ndesh me pikën 9 të nenit 7 të rregullores nr. 1/95 me datë 24.06.2021 ku ceket se në Universitet të Prishtinës nuk mund të angazhohen kandidatët të cilët kanë më shumë se një angazhim në marrëdhënie të rregullt pune apo honorar në institucione publike apo private me pagë primare apo sekondare. Rrjedhimisht, kandidatja në fjalë **nuk propozohet** për pozitën në të cilën konkuron.

Komisioni vlerësues

5. Kryetar
6. Anëtar
7. Anëtar

Prof. Asoc. Dr. Lindita Tahiri

Prof. Ass. Dr. Blerta Mustafa

Prof. Ass. Dr. Lendita Kryeziu